

LULZIM KALAJ

NDASHTË...
POEZI

Lulzim Kalaj

NDASHTË...

Poezi

Ndashtë...

Autor: Lulzim Kalaj

Redaktor: Azem Baliaj

Recensent: Viktor Gjokolaj

Korrektore: Elona Capo

Design & Kopertina: Hekuran Koka

© 2018 Lulzim Kalaj

Dy fjalë rreth librit “Ndashtë...”

Pas librit të mirëpritur “I imi mekat...” 2011, Lulzim Kalaj vjen para miqve lexues përsëri me shqetësimet e përditshme të shpirtit poetik, të cilat, në pothuajse krejt krijimtarinë e tij ngjajnë me të përditshmen e të gjithëve... Vijnë me vargjet e ndezura nga prushi i puthjes, nga loti i ndarjes, nga malli i zemrës, nga të papriturat e hidhura, nga fatet e dilemave, nga vuaajtjet durimtare, nga shpresat fisnike, nga ironia e domosdoshme, nga toleranca shpirtërore, me një “Ndashtë...” herë të thënë me dhimbje, herë si dashnor i kallur, herë për të zhvlerësuar dështimet, herë si ngjallje ëndrre, herë si kushtrim vllaznor, herë si ledhatim stinësh, për një të nesërme më të bukur të cilën e dëshirojnë dhe e presin të gjitha moshat, gjinitë, kombet, por poetët e parashpjegojnë më ëmbël, më shpejt, më dashurisht e, në mos u realizoftë ashtu si e dëshironin, nuk vajtojnë, nuk bien në dëshpërim edhe pse shpirti u dhemb. Ata, poetët, trishtimin e “fshehin”, në rastin tonë, Lulzim Kalaj, e “fsheh” në një, “Ndashtë...” poetike që buron nga dritëhijet e jetës, jo vetëm të tij, për të na bërë edhe ne lexuesve, ëndrrimtarë si veten, të guximshëm si veten, të ndjeshëm si veten! Ndonjë pakënaqësi e vogël që piklon shijet tona në çdo lloj leximi autoresh, nuk na pengon ta “përcjellim” këtë libër të ri dashamirësisht, me një “Ndashtë...” të këndshme...

Azem Baliaj

“Ndashtë...” jeta asht poezi

Tek libri “Ndashtë...” që në titull autori shpall bashkë me ftesën, në një bashkëbisedim krejt origjinal e të sinqertë, dhe ftesën brenda një “faljeje” të madhe!

Që në titull e deri tek poezia e fundit, duket sikur kemi shpirtin e fjalëve, që jo vetëm e don njeriun dhe jetën, por vazhdimisht e pranon ashtu siç është ai, ajo, pa pretendimin për t’i ndryshuar a refuzuar!

“Ndashtë...” do të thotë: -s’ka gjë, që ti s’je kaq e bukur, ti bëhesh e bukur prej shikimit tim.

“Ndashtë...” S’ka gjë, nëse ti nuk je e përkryeme, ne mund ta bëjmë bashkë të përkryerën!

“Ndashtë...” S’ka gjë nëse vitet shkojnë, ne mund t’u trashëgojmë dashurinë atyre që vijnë!

“Ndashtë...” S’ka gjë se ti nuk e ndjen mungesën time, unë jam gjithë prania jote!

“Ndashtë...” S’ka gjë nëse nuk biem në sy, jetohe me bukur brenda shpirtit! Brenda këtij libri e kësaj poezie nuk jetohe ndryshe, veçse ashtu siç mund të jetohe brenda një shpirti të papërsëritur!

Elinda Marku

MËKATAR

Unë mëkatar i epokës sime,
Kokën lart e mbaj krenar,
Se më pëlqen në jetën time,
Në dashuri, t'jem mëkatar.

Hapin tim dot jo, s'e ndal,
Mënjanë e lë njerëzinë,
Le të më quajnë, imoral,
Se mëkat kam dashurinë.

Në ardh të dita për rrëfim,
Ku mëkati të dënohet,
Le ta djegin shpirtin tim,
Për dashurinë le të flijohet...!

E BRISHTË...

Mundohem në vargje të të përshkruaj,
Me ndjenjë të shpalos rrezatimin tënd,
Sado që me metaforat, marr e luaj,
Shkëlqimi yt, për vargje ...s'lë vend.

Rrezatimi i yt sa i rrallë, hyjnor,
Vlen më shumë se çdo pasuri mbreti,
Shikimi yt, sa i ëmbël..., dashuror,
Nuk përshkruhet në vargje poeti.

Me shikim shijoj pamje, buzë, sy,
Në ëndërrime përhubem me dëshirë,
Shpreh, gjithë bota të ishte si ti,
Sa jetë e ëmbël, sa jetë e mirë.

Në emocionet e një zjarri të fildishtë,
Në përshpëritje... e ëmbël, E BRISHTË.

MË GUR SE GURI...

Dallgët e detit godasin pa mëshirë,
Kanë marrë huj', s'dinë të ndalen,
Porsi një gur mbi rërë i shtrirë,
Përgjërohem, lutem, diku veç falem.

E unë si gur, më gur se guri u bëra,
E çirrem, zvogëlohem, ndjej siklet,
Po i humb, i zhduk, po i humb të tëra,
Se s'jam gur, që peshon n'vend të vet.

Dallgët ma gërryejnë sipërfaqen time,
Krijojnë nga jashtë relief të ashpër,
Por shpirti im tejmbushur trazime,
S'di të ndyhet, ai mbetet i pastër.

Dhe prapë mbeta një gur me shpirt,
Ndonëse nga pamja ngaj me mumjen,
Shkëlqej gjithkund e shpërndaj dritë,
I thërras dallgës, pranoje humbjen!

Si një gur i lashtë dhe i palëkundur,
Triumfator, ju thërras e krenohem,
E palos dallgën kokëposhtë, të mundur,
E i them prerë "nuk tjetërsohem".

E ushton zëri i fortë prej burri,
Unë jam një gur, më gur se guri!

S'MUNDEM TË HARROJ...

S'mundem të fshij nga kujtesa ime,
Atë zjarr dashurie, që ti më ke dhuruar,
Me mijëra rrahje zemre, ndjenja, tundime,
Si mund t'i mbyll në një arkë të gozhduar?!

S'mundem të fshij stinën e jetës,
Të zhduk mrekullitë që kam n'memorie,
Si mund të arrij në fshirje t'vetvetes,
Si shkrimet me laps të një fletoreje.

Të jem larg teje, përsëritet, thuhet,
Për ty të mos ndjej, të pranoj vetminë,
Zjarri dashuror si mund të shuhet?!
Si mundem të rroj pa dashurinë?!

Rri e vetveten më kot lëndoj,
S'mundem dot, të të harroj.

VETËM NË SYTË E TU

Mendja e shpërndarë, tretur kuturu,
Dëshirat dhe epshet janë shpërndarë,
Si pikë referimi kam veç sytë e tu,
Një tempull i shenjtë, tempull besimtar.

Në sytë e tu shoh dhe kuptoj,
Aty udhëtoj në botën qiellore,
Përhumbem, tretem, aty dashuroj,
Përherë aty gjej kënaqësi shpirtërore,

Vetëm në sytë e tu shoh mirësinë.
Aty shoh diellin, aty marr dritën,
Veç në sytë e tu, gjej dashurinë,
Aty buzëqesh, çlodhem, mahnitem.

Vetëm në sytë e tu të kaltër, të kulluar,
Do lutem, do falem, do bëj mëkat,
Gjithë jetën me to do jem i dashuruar,
Në pafundësi dhe pa afat...

NË MUZGUN E MBRËMJES

Çapitem në muzgun e mbrëmjes,
Hapat i hedh me ritëm të ngadaltë,
Sa shumë më shtohen rrahjet e zemrës,
Kur ti më shfaqesh e ëmbël, e zjarrtë.

E rend pas teje me vrull në muzg,
Me zjarr e dëshirë, aty unë të vij,
Shtangem në vend, kthehem në murg,
Ajo që unë ndjek, nuk qenka Ti.

Memorja ime është çorientuar,
Dhe syri im për ty është tharë,
Se aq shumë më ke munguar,
Koha e gjatë, ne, pa u parë...

Kujtimet për ty vërshojnë lumë,
Gjithmonë tek unë je në mendime,
Shfaqesh kudo, në ëndërr, në gjumë,
Si në muzgje dhe në agime.

DIKUR...

Dikur, me stilolaps përcillnim
mesazhe dashurie,
Me shërbëtorin besnik, timin
dhe tëndin,
Tani, dy fantazma të zhdukura,
dy hije,
Gërmojmë në memorie, momente
që na dhembin.

Dikur, ushtonte ngado fjala:
- të dua,
Si jehonë malesh, si zjarr
Shkrepëtimë,
Por nuk vonoi, shpejt
u shndërrua,
në mbetje të tepërt, të shpirtit
pashirrmë.

Në memorie shijojmë, filmin
e vjetër... “Dikur...”
Duke mos u parë, as dëgjuar
më kurrë...

2012

TË NJËJTIN GABIM

Të gjithë dashurinë që kisha, ta shpreha,
Ta dhashë në dorë, shpirtin ndjesor,
Nuk mbajta për vete, asgjë nuk fsheha,
Tani vetëgjykohe, i dobët, fajtor.

Çdo fije ndjenje, ta zbërtheva në fjalë,
Çdo rrahje zemre, e derdha në varg,
Dëshirat e shpirtit, t'i përcolla valë-valë,
E u ktheva në sfinks, të ngrirë diku larg.

E prapë, ti mbetesh pjesë e shpirtit tim,
Që kurrë s'mund ta fshij, as ta harroj,
Përsëri do bëja të njëjtin gabim,
Sa herë të të shoh, sa herë të të takoj.

E mbetem i etur, për çastin sublim,
Me dëshirë të bëj, të njëjtin gabim.

MENDO...!

Në trazimin shpirtëror, të një mërzie të çastit,
Çdo gjë të duket se humbet, pa orbitë,
Mallkon pa fund, udhët e tua të fatit,
E dielli që lind, s'të ngroh, as bën dritë.

Në një çast të tillë, të vështirë,
Mos mallko, duke çuar çdo gjë në dreq!
Mendo... se nesër do të bëhet më mirë,
Mendo... ndonjë tjetër mund të jetë më keq!

2011

NË ËNDËRR

Në ëndërr më shfaqet, e hijshme gjithnjë,
E rend për të kapur, atë që nuk kapet,
Atë që nuk shihet e gjurmë nuk lë,
Një lule të mbyllur, që s'di të hapet.

E mbaj në ëndërr, të shenjtë, të njomë,
Qenien e saj, që më mbush me aromë.

KAM HARRUAR TË BUZËQESH

S'më del buzëqeshja, në kohët e mia,
Kur këmba më shkel, mbi bar të vyshkur,
Vështroj përreth.... Ku është rinia?!
Sa më ngjan me metal të ndryshkur.

S'më del buzëqeshja, në udhët e jetës,
Kur shoh veç lot, nga të moshuar,
Kthyer në murgj t' braktisjes, heshtjes,
Si rudiment... krejt i mohuar.

S'më del buzëqeshja, në hapat e kohës,
Kur shoh në rrugë, duar të shtrira,
Që marrin përçmim, nga mosmirënjohës,
E s'kanë një shans, për ditë më të mira.

S'më del buzëqeshja, në portretin tim,
Kur shoh më shpesh, t'zezat shamia,
Drejtuar qiellit, plot sy jetim,
Që i ka braktisur edhe perëndia.

S'më del buzëqeshja, më shembet zemra,
Dhe shpirti im, shkon bëhet nyje,
Tek shoh viktimë dhe më shpesh femra,
Nga përtej kafshë, fund e krye!

Dhe vetes sime, më shumë i bie ndesh...
Se kam harruar, të buzëqesh.

PRITJE

Në stuhi, në dallgë, në erë,
Në rrebeshet e kohës së vrazhdë,
Me figurën tënde mbështjellë,
Si një hije e kohës, së lashtë.

Rropatem, zhgënjimtar i rrënuar,
Dashuritë e praruara, lë pas,
Larg teje, një qenie e mohuar,
E shpirti, i mbushur maraz.

Çapitem, pa ditur se ku,
Pa busull, krejt pa drejtim,
Me shpresë, të të ndesh diku,
Në këtë botë të pambarim.

Duke kujtuar ato ditë fundvjeshte,
Me shpresë dhe në perënditë,
Si murg, i përhumbur, në heshtje,
Që pres, të më shfaqesh një ditë.

S'MUND TË MBAJ

Unë s'mund të mbaj mbi supe, çka s'më përket,
Atë që plagët m'i çjerr e dhunshëm, m'i gërvisht,
Se jam një njeri, që fort shpirti i flet,
por s'mund të bëhet, kurrë Jezu Krisht!

Unë s'mund të mbaj, përherë trishtimin,
As lotin a dhimbjen, që shpirtin ma vret,
Por si njeri kërkoj, dashurinë e gëzimin,
E çdo gjë të bukur, që mua më përket.

Unë s'mund të mbaj, gjithë jetën shpresë,
Në ëndrrën e bukur, të një imazhi të vakët,
Duke patur brenda vetes, hije në kujtesë,
Një hije nga një trup, gjithmonë më i largët.

Dua të punoj, të gëzoj, të qesh e të qaj...
Një jetë në shpirt, dhimbje s'mund të mbaj.

HESHTJE

Heshtja trokiti, si shkrepëtimë moti,
E derën, s'desha asnjëherë t'ia hap,
Ajo vjedhurazi hyri, si një rrëshqitje loti,
Dhe mua në heshtje, më ktheu pak nga pak.

Era e ndarjes na shpërndau, si gjethe vjeshte,
Për t'u tretur e zhytur, përgjithmonë në heshtje.

NJË ME QIELLIN

Në qiellin tonë, ëndrra u përhumbar,
Gjithçka e plotë, pa inicial,
Shijim në epsh, një natë pa fund,
Nën sfondin gri, magjik, real.

Një natë pa gjumë, në tonin qiell,
Sytë, kapakët s'ditën t'i mbyllin,
Gjithçka shkëlqim, pa hënë, pa diell,
Përveç një drite, që ngjan me yllin.

Pasionet humbur, në ritme të zjarrrta,
Që krejt pa ndrojtje, vallen e hedhin,
Si pa kuptuar, na humbi nata,
Në një të bërë, të dy me qiellin.

KONTRASTE JETE

Luftë momentesh,
meshkujsh,
femrash.
Përplasje dhimbjesh,
besimesh,
iluzionesh.

Konflikte,
kundërshtime,
thyerje zemrash.
Mungesë dashurie,
shpërthimesh,
pasionesh.

Patos në të bukurën,
që të rrëmben frikshëm.
Fluturim në qiej,
planete,
galaktika.

Mbetur në vend,
mrekulluar mahnitshëm,
Dy satelitë,
të dalë nga orbita.

Një laps konfigurron,
në bardhësinë e një flete,
Çaste,
momente,
Kontraste jete.

IKONË

Mora e vendosa, prapë në altarin tim,
Ikonën tënde, që të lutem, të falem,
Para saj të përulem, deri në amshim,
Aty ku u treta, aty të ringjallem.

E t'i shpalos, gjithë mëkatet e mia,
Si një grusht i vetëm, vetëmohimi,
Dhe ti, si gjykatës të jesh perëndia,
Në ditën time të shenjtë, të dënimit.

MEDITIM KONFUZ

Po pres në ankth, lindjen e perëndimit,
Të shkëlqejë, drita e hijes që shtrihet,
Që ta festoj, fitoren e vetëmohimit,
Me lotin e shpirtit, që skutave fshihet.

Buzëqesh sa mundet, buza e çarë,
E kënga pa zë, kumbon si asnjëherë,
Heshtja thërret, më të ëmblat fjalë,
Mushkëritë mbushen, pa ajër, në erë.

Mendimi udhëton, pa motor, në tren-autobus,
Hyu bekon..., meditimin konfuz!

NJË FESTË...

Një festë flamuri, pa flamurtarë,
Një festë atdheu, pa atdhetarë,
Një festë lirie, që s'ka të ngjarë,
Një festë gëzimi, me sy të qarë.

Një festë kombi... të shpërndarë,
Një festë bashkimi, mes nesh të vrarë,
Një festë dashnie, me thonj në varr,
Një festë... si festë, krejt e paparë!

E gjithë hare, "të lumturuar"
Gëzuar festë, o festë gëzuar!

PËRSE MA VRAVE ENGJËLLIN?!

Të vura në zemër, me zjarr vetëtime,
Të mbajta atje, ku yjet shkëlqejnë,
Në botën time, të shenjtë, intime,
Si valë ndriçuese e shpirtit, emblemë.

Dashuria për ty, ish' një me jetën,
Në brendësi shpirti, në çdo detaj,
Mora e të bëra, një me vetveten,
Në engjëll të bukur, engjëll të pafaj.

Ike... u zhduke, pa zë, pa valixhe,
Le pas veç plagët, që fort më dhembin,
E s'mora kurrë nga ti një përgjigje,
Përse, përse ma vrave engjëllin?!

S'KA RËNDËSI NË PARAJSË A NË FERR

Udhëtoj në dashuritë e mia të zjarrta,
Diku gjithë gëzim, diku i përlotur,
Kur i numëroj, më duken të pakta,
Me dashuri njeriu, qenka i pangopur.

E rend me vrull, në dashuri të reja,
Si një i uritur, që kurrë s'ka dashuruar,
Drejt mollës së ndaluar, nga ligji e feja,
Me dëshirë shpirti, për t'u vetëflijuar.

Në ditë të gjykimit, i djeg alibitë,
Pa dashur të di, në ka diell a është terr,
Duke mbajtur me vete, gjithë dashuritë,
S'ka fare rëndësi, në parajsë a në ferr.

DORA

Gishtërinjtë e dorës, janë të shpërndarë,
Të gjithë të fryrë, si gungat e ftoit,
Me njëri-tjetrin, gjithmonë të paparë,
Dikush bjeri thumbit, tjetri patkoit.

Janë shtrembëruar, krejt nyje e gremça,
Të gjithë të zgjuar, të tjerë të mohojnë,
E ngrihen me vrull si anza a grenza,
Kë të përdhosin e kë të thumbojnë.

Muskujt nga lodhja, janë të sflitur,
Dora rënkon, se dot s'i mbledh gishtat,
E rri në mendime, mrekullinë duke pritur,
Si tavllë cigaresh, veçse mbledh bishtat.

Qëndron e përçartur, si vera në gusht,
E lutet në Zot, m'i bëj gishtat grusht!

DEBAT ME PENËN

Ngatërrohem shpesh, me penën time,
Bëhemi uthull, debat i thartë,
I them asaj, ti s'je sublime,
Se ti nuk je, një penë e artë.

Them, ti je si laps a si thëngjill,
I marrë diku, nga zjarr i shuar,
Ti s'je e shenjtë, si një ungjill,
Me ty t'krenohem, duke shkruar.

Më vështron pena, me ironi,
Me mua tallet, me mua qeshet,
Thotë, nga unë, pret krenari?!
Gomari vallë, çalon nga veshët?!

Në vargu yt, ka aq shumë vlerë,
Në vlerë e fjalës, s'të humbet kurrë,
Mos më përdor mua, fare si penë,
Merri e gdhendi ato, mbi gur!

SHPËRNGULJA

Më në fund, po mbledh çdo pjesë jete,
Çdo grimcë malli, loti, çasti të gëzuar,
Po marr çdo gjë ta kem me vete,
Çdo gjë mërgimi të përjetuar.

Po bëj gjithë vitet, një grusht shpirtëror,
Të mira, të këqija, gjithçka ka ndodhur,
Duke u kthyer në trugun atëror,
I vuajtur, i zbrazët, tejet i lodhur.

Nuk di pse kthimi po më jep mërzi,
Nuk di pse shpirti është ngritur peshë,
Them, kthimi im ka pak rëndësi,
Ky nuk është kthim, si i Odisesë.

Por unë po shkoj në tokë të t'parëve,
Mbështjellë shpirti, si lëmsh orteku,
Shkoj si shqiptar, në mes shqiptarëve,
Ndonëse do thonë, na erdh' "ky greku"!

Po kthehem pra, në timen çerdhe
Këndej për bukën, lë një mirënjohje,
Andej pranë jush, një mirë se erdhe!
Që shpirti im të marrë pak ngrohje.

Ah, si është krijuar kjo jetë!
Asnjë shpërngulje nuk është e lehtë.

01-02-2012

NDASHTË

Ti s'din me dashtë, s'ke ditë kurrë me dashtë,
Se akullnajën tande, s'e shkriu askush,
Dashnia që ti jep, asht si flaka me kashtë,
Që digjet rrufeshëm, e n'shpirit nuk len prush.

Ti s'din me dashtë, as kurrë s'ke me ditë,
Se dashninë s'e sheh si dëshirë të shpirtit,
Kur korpi e shpirti s'takojnë perënditë,
Dashnia do ngjajë me mumje t'Egjyptit.

E... ndonëse s'ke ditë, as din me dashtë,
Shpirti em që të don, thotë: -...Ndashtë, ...ndashtë

MË MIRË ISH DJE, A MË MIRË SOT?!

Sot në këtë jetë, nuk ka fishek në pajë,
As fëmijë në djep, jo nuk përkundet,
Por sot është koha t'i thuash derrit dajë,
Ku çdo injorant të tërheq për hunde.

Sot në këtë jetë, nuk ka xhubletë e çakshir,
Se iku koha e veshjes së lashtë kombëtare,
Por sot është koha ku sundojnë vampirë,
Që veshin kostume, këmishë e kollare.

Sot në këtë jetë, nuk ka zi buke,
S'ka malarje, jo që jo kolerë,
Por ka të pangopur, të unshëm, llupës,
Që s'dinë të ngopen, jo asnjëherë.

Dhe unë bëj pyetjen, ashtu, kot së kot,
Më mirë ish dje, a më mire sot?!

FALJA

Të gjithë do t'i falja, në këtë jetë,
Çdo gjë do fshija si të pavlerë,
Por falje nga unë jo, s'do të ketë,
Për mosmirënjohësin, asnjëherë!

KUR...

Kur patët nevojë për mua, vrapova,
Renda pa ndalur dhe u gjenda pranë,
Kur për praninë tuaj më lindi nevoja,
U zhdukët të gjithë, më latë në një anë.

SA MIRË TË JESH, NJERI I THJESHTË

Në ditën time të promovimit,
Shpirti ndriçoi porsi diamant,
Aty munguan “baronët” e krijimit,
Ata që miun bëjnë elefant.

Munguan dhe njerëzit me “etikë”,
Nuk pat as kamer as televizor,
Se ishin të zënë me politikë,
E pranë të thjeshtëve u vinte zor.

Kur nuk di fjalë me përzgjedhje,
Fjalorin e të “lartëve” kur s’e di mirë,
Kur s’ke parti e s’ndihmon zgjedhje,
Figura në ekran s’të del e dliërë.

Një zë vogëlusheje, sallën ushtoi,
Ç’kënaqësi e vlerë, pat fjalë e saj,
Kur poezinë e “Nënës” mori e lexoi,
Bëri gjithë sallën, me lot të qaj.

E shpirti im më tha me vrull,
Mos rri si gjeth i tharë në vjeshtë,
Shkruaj poet, shkruaj më shumë,
Sa mire të jesh, njeri i thjeshtë.

PERDJA RA

Perdja ra, për t'mos u ngritur më,
Skena u shemb, përcolli dhimbje,
Çdo gjë u zhduk, nuk mbet' asgjë,
As ditëzhdukje, as ditëlindje.

Si një yll që shuhet në qiell hava,
Çdo gjë u shua, kur perdja ra.

THASHË TA PROVOJ

Më iku durimi i shpirtit prej burri,
Pas hijeve trishtuese duke rendur,
E krejt nga koka më iku truri,
Thashë ta provoj njëherë si i çmendur.

TI FEMËR

Ti femër e dëshirave të mëdha,
Lakmitare e salloneve luksoze,
Mos qëndro me kokë lart në hava,
Me kërkesat e tua tekanjoze.

Nëse zoti të fali bukurinë,
Me një pamje hyjnore, siluetë,
Mos rend veç për pasurinë,
Ajo sështë gjithçka në jetë.

Mos u turr si krijesë lavire,
Duke parë veç xhepa të fryrë,
Për pasuri e pangopur, vampire,
Pa shije, pa formë, pa ngjyrë.

Kuptoje mirë, ti femër,
Që lakmon aq shumë pasurinë,
Po kërkoje xhep, e jo zemër,
Kurrë s'do ta gjesh dashurinë.

BOTË E ÇMENDUR

Gjithmonë kërkoja, të më linin të qetë,
Në çmendurinë time, të rrallë, të çmendur,
Se doja ta jetoja, të ashtuqajturën jetë,
Në ëndërr-dëshirat e mia, ngaherë duke rendur.

Me pasionin e shpirtit, të bërë copë-copë,
Përherë dëshiroja, pak qiell në hapësirë,
Të kisha pak vend, si i çmendur në tokë,
Të thërrisja me të madhe, për botën e lirë!

Por gurë shumë të rëndë, mbi supe më vunë,
Thashë: - botë e çmendur, më e çmendur se unë.

KALI

E keni dëgjuar historinë e kalorësit me kalin,
Mbas fitores, kalorësi brohoritej me një zë,
E kali ngazëllehej për dashurinë që i falnin,
se mendonte i shkreti, adhurimi ishte për të.

Po sot a ka? Sot a ka kalorës triumfatorë?
Nëse ka, ju lutem më tregoni, më çoni fjalë,
Ju betohem me dëshirë do bëhem therorë,
Pa mëdyshje do kthehem nga njeri, në një kalë.

DUAJE VETVETEN

Kur ekuilibri shpirtëror të lëkundet,
Nga përballje, vështirësi me jetën,
Që vlera e jetës të mos zhduket,
Mendo më gjatë, duaje vetveten.

Kur je rrëzuar a poshtë ke rënë,
E çdo gjë të duket, e pa vlerë, e huaj,
Kur je i mbytur në lot e gjëmë,
Mendo më thellë, veten duaj.

Kur ëndrrat, shpresat të duken të kota,
Dhe s'të shijon asnjë dëshirë,
A kur nën këmbë të rrëshqet toka,
Duaje vetveten, të ndihesh mirë.

Që jeta të buzëqesh, të ketë vlerë,
Duaje vetveten, të duash të tjerë.

ATJE

Atje ku ëndrrat ngjajnë shëmbëlltyra,
Ku dëshira dhe shpresa dot nuk gjen,
Atje ku e ngrysur të rri fytyra,
S'dua të ndodhem, as dua të jem.

Atje ku buzëqeshja është e shtirur,
Ku ndjenjat e zjarrta, përbalten, përçmohen,
Atje ku mjalta është helm i hidhur,
Me plot bindje, s'dua të ndodhem.

Atje ku dashuria është peng i interesit,
Ku sot shumë të dua, nesër të mohoj,
Atje ku i rremë lind dielli i mëngjesit,
S'dua të jem, me shpirt e pohoj.

Nëse lind pyetja: Ku do mbi dhe?
Në çdo vend tjetër, veç, jo atje!

SA SHUMË MË MUNGON

Sa më shqetëson ky mëngjes i athët,
Mungesa jote se ç'më jep vuajtje,
Mendja zhdërvillet krejt zbehtë e ngathët,
Shpalos pamjen tënde, që ka në ruajtje.

Kujtimet rrjedhin, vërshojne si krua,
Emocionet tunduese, shkrepëtin moti,
Blokohen kujtimet tek fjala të dua,
Qerpiku laget nga një pikë loti.

Boshllëku mbush kraharorin tim,
Shpirti kërkon në hapësirën pa fund,
Porsi një zog që kërkon ushqim,
Por jo nuk gjendesh ti askund.

Dhe i përçartur ngushëlloj vetveten,
Me shpresë, që të shfaqesh përsëri.
Pres një sinjal diku të shkretën,
Që vetëtimthi, të jem tek ti.

Asgjë tjetër veç shpirtit, nuk e beson,
Sa shumë, sa shumë më mungon...

S'MUNDEM DOT...

Po marr të fshij çdo gjë tënden,
Po fshi çdo hije, shenjë, gjurmë,
Po them se ishe veçse ëndërr,
Një ëndërr vere, asgjë më shumë.

Po fshi biseda, diku takime,
Po fshi dhe fjalë apo mesazhe,
Të gjitha zjarret e zemrës sime,
Si shkrime në rërë, me tallaze.

Po e fshij e thaj shpirtin prush,
Sikur në shpirt, asgjë s'ka ndodhur,
Po bëhem unë, një tjetërkush,
Po i them vetes, kurrë s'të kam njohur.

Dhe bëhem gati ta festoj fitoren,
Por s'mundem dot, të fshij memorien.

BRIGJEVE TË VALBONËS

Ndër male thepisur fluturon mendja ime,
Atje ku uji rrjedh, i kristaltë, i ftohtë,
E bashkë me ujin me mijëra kujtime,
Mendjen ma dalldisin, ma bëjnë çorbë.

E kristaltë rrëshqet pamja, krijesë zoti,
Fytyra e pastër si përherë, buzëqesh,
Bulëzat e ujit të kthjellta, si loti,
E goja e mugët, mediton e hesht.

Mendja më thotë, do vij prapë ndër male,
Ku puhiza jote, të ma rrënqethë trupin,
Që shpirti të rrëshqasë, në shkumë të një vale,
Si adoleshent i ndrojtur, në të ta heq turpin.

E prapë... e prapë, valë pas vale...
Tingujt vijnë pas, me ndihmë të jehonës,
Me kujtimin tënd, diku... ndër male
Meditim i heshtur, brigjeve të Valbonës.

UJËVARË

Ujëvarë mendimesh bie, copëzohet në mijëra thërrime,
Në fluska të mëdha, të vogla në shkumë e valë,
Tentakula shpirti shpërndajnë dritëhije shprese,
Pa ditur ku ndodhen, ku shkojnë a ç'kërkojnë vallë.
zhgënjime,

Unë arkitekti i ujëvares sime të shpërndarë, të lëkundur,
Pëzgjedh e shpërndaj copëza, fluska e shkumë,
E veç rrezatimi yt, më bën krejt të përhumbur,
Aty ndizem, shkrihem, tretim, pyes veten, a jam unë?!

E vazhdoj, pa reshtur, pa ndalë...
Përsëri në të njëjtën ujëvarë.

NOTA TRISHTIMI

Si luftëtar ndaj trishtimit e humba vlerën,
Fuqitë më lëshuan në mënyrë të çuditshme,
Bestytnitë e pasioneve fluturuan me erën,
Dëshira të thara, të pafuqishme.

Shpirti i mbledhur guackë sa një grusht,
Një grusht i lodhur në valë mërzie,
Shpresa marrë rrugë, si vera në gusht,
Pritja e shndërruar në ëndërr a hije.

Muzika shpërndan tinguj mosbesimi,
Luajtur në piano, me nota trishtimi.

PËR TY KAM SHUMË NEVOJË

Kur gjithçka më duket e turbullt përreth,
I mbuluar mërzi si penë pa bojë,
Kur vetulla ngrysur e buza nuk qesh,
Për praninë tënde kam shumë nevojë.

Kur hallet e jetës më gjenden në prag.
E dallgë ma trazojnë shpirtin nga çdo anë,
Kur letra e bardhë kërkon ndonjë varg,
Kam shumë nevojë të të kem pranë.

Ku syri s'më mbyllet në netët e gjata,
E përballimi s'më lë të fle gjumë,
Kur hënëplota lëshon rreze t'arta,
Pë ty në ato çaste kam shumë nevojë.

Dhe kur gëzoj, qesh a jam i lumtur,
E jeta më përcjell çaste të magjishme,
Kur shpirti gazmend është i përhumbur,
Kam shumë nevojë të jesh e pranishme.

Që vetvetja ime, jetën ta kuptojë,
Për ty gjithmonë ka shumë nevojë.

I HUAJ?!

Më thanë, mos shko në vendin tënd,
Rri më mirë, nga larg dhe vuaj,
Në atë vend, thanë, s'do gjesh vend,
Por do të shohin si të huaj.

Më thanë mos shko, atje mos ik,
Dhe pse malli, shpirtin ta djeg,
Se s'do të shohin si vëlla a mik,
Por si një shkja, a si një grek.

Më thanë, mos merr rrugën e kthimit,
Mos shko atje, ku rrite shtatin,
Se do të mbulojë reja e zhgënjimit,
Atje s'të japin, veçse të zhvatin.

Mjat! - u thashë, me zë të xhindur,
Dhe qenies sime, i thashë -hesht!
Do shkoj atje ku unë kam lindur,
Aty ku linda, aty të vdes.

Tani, me vetveten rri e digjem,
Çdo fjalë të tyre me shpirt e bluaj,
E s'jam në gjendje, të kthej përgjigjen,
Me të vërtetë, a jam i huaj?!

BOTA

U nisa me vrull, me hapa gjigandë,
Si i marri thashë: - do ta ndryshoj botën,
Por mbeta i vetëm, në një vend vakant,
Larg me qiellin, larg dhe me tokën.

Vrapova pas saj, me sprint të një qindëshi,
Por s'kapej dot më, nga unë bota,
Se ish' e mbërthyer në krahë përbindëshi,
Më kishin gënjyer, s' ishte me rrota.

PORTRETI I POETIT

Shohin me kostum e kollare,
E mendojnë, ky është "boss",
Fjalë, biseda, plot pazare,
Xhepi... jo, s'ka një grosh.

E takojnë nga afër,
Me pallton e tij të vjetër,
Oh, ky qenka i varfër!
E ngatërruam me tjetër.

Kur e dëgjojnë nga zëri,
Fjalëbutë, ëmbël, e shtruar,
Përshkrimi ndryshon i tëri,
Thonë, qenka i urtë e i zgjuar.

E kur ja zbërthejnë shpirtin,
Diamant i çmuar mbretëror,
Me njëri-tjetrin, pëshpëritin,
Ua, ky qenka shenjtor!

Kur mendimet në vargje, pa dashur,
Shkëputen nga tallaz a valë e detit,
Shprehem pa vetëdije, i kënaqur,
Sa me vlerë, portreti i poetit!

MË MJAFTON

S'i dua fjalët, as ëndërrat më, jo s'i dua,
S'i dua as lulet e freskëta, gjithë aromë,
Ngopem nga ëmbëlsia e puthjeve të tua,
Më mjafton epshi, i buzës së njomë.

S'i dua margaritarët e ndritshëm, vezullues,
As mrekullitë e botës, jo s'kam ç'i dua,
Më mjafton vullkani i syve zjarrpërçues,
Që ndjenjat m'i kthen në burim a në krua.

E përderisa për mua, ti ekziston,
Nuk dua gjë tjetër, ti më mjafton.

SHUPLAKA

Ndihmë kërkova nga ti, me dhe një shuplakë,
Sytë më nxorën xixa, e faqja fort m'u skuq,
Inati, brenda digjej, si një llavë me flakë,
Shpirti e shuajti, si rrjedhë uji në prush.

Inatin, zemërimin, dhimbjen tej e flaka,
Thashë ta kaloj, si një lojë mes fëmijëve,
Por prapë s'u zhduk, përgjithmonë shuplaka,
Në fytyrë më mbetën, shenjat e gishtërinjëve.

Sot, nga ti shoh, diçka të më kërkosh,
Dua të jem i kthjellët, me zotin të paktën,
Them, s'e kthej dot këtë "mik" duarbosh,
Por, s'mundem dot, ta kthej shuplakën.

PERANDORI RA!

Perandori ra, përtokë u shemb,
Dheu u drodh, i tëri nga pesha,
Diku një plagë, që aq fort dhemb,
Unë dot nuk qava, dot as qesha.

Me rrënjen e tij, shpirtëra u lënduan,
Aq shumë, sa zotin çjerrtas mallkonin,
Ndërsa ata, që vetë e rrëzuan,
Në turmë qeshnin, në turmë gëzonin.

E unë prapë s'qesha, e prapë nuk qava,
As dhimbje s'ndjeva në kraharor,
Në brendësinë time, mendimin ngjalla,
Do qaj për tjetër perandor.

Kur perandori im, u shkri në letër,
Thashë s'ka gjë, do lindë një tjetër...

SHUMË HERË...

Shumë herë s'i kuptoj, zogjtë me cicërima,
Tinguj shpërndajnë në çdo kohë pareshtur,
S'kuptoj në janë këngë a vaj me drithërima,
Të botës së zhurmshme, të botës së heshtur.

Shumë herë s'e shijoj, tingullin, muzikën,
Dalë nga lahuta, daullja a pianoja e vjetër,
Se herë më gëzon, herë më kall frikën,
Si tallje e jetës me ne, a e jona me jetën.

Shumë herë s'perceptoj buzëqeshjen e ëmbël,
Joshja e buzëve në shpirt më jep goditje,
Të vërtetën e marr, sikur të jetë ëndërr,
E ëndrrën, si reale të dalë jashtë orbite.

Shumë herë s'arrij dot, ta kuptoj botën,
Çfarë shoh e dëgjoj ma humbasin fillin,
Vë në dyshim, në ka shenjtër e zotër?!
Kur lart ngrejnë të keqin, turturojnë të mirin.

E prapë, e prapë, dilema shumë herë,
Kthyer vera në dimër e dimri në verë!

U TËRBUA BOTA

U tërbua bota, krejt u çmend,
Me të panjerëz, që shtohen çdo ditë,
U prish dynjaja, u çmenden dhe qentë,
Me ato që shohin, në kaos e frikë.

E qeshim përditë, qeshim fukarenjtë,
Për të ardhmen tonë, që s'ka të ardhme,
Qëkur djajtë dalin, më shumë të shenjtë,
E varrezat tona shtohen me varre.

E kënaqet rruzulli, me çdo arritje,
Për jetën që fituam, e gëzojmë sot,
U lodhëm ndër ne, u lodhëm në pritje
Zotërit na tradhtuan, skemi më zot!

Në llumin tonë, kënaqemi me llumin,
Që vetes sonë, me gëzim ja servirim,
Mendojmë se ia hodhëm, kaluam lugin,
Ngrejmë lart të keqin e mbysim të mirin.

Në fund, gjithë fajin e hedhim mbi zota,
E s'pranojmë se nga ne, u tërbua bota.

PASZGJEDHORE

Të gjithë të humburit, kanë fituar,
E të fituarit, gjithmonë fitojnë,
I sheh të gjithë, të lumturuar,
Por s'dinë ku janë, as dinë ku shkojnë.

Fituesit janë gjithmonë, ata që humbin,
E humbësit prapë, humbës mbeten,
Të parët, kala ndërtojnë me llumin,
Të dytët, tallen me vetveten.

Kur vjen puna, bëjmë analizë,
Për të ardhmen na zë belaja,
Në botën mbarë që është në krizë,
Gjithkund haraçet, lan fukaraja.

KROZHAT

Asht' epoka e veçantë, epoka e krozhave,
e krozhave të vuajtjes, krozhave të luksit,
e krozhave të mëdha, e krozhave të vogla,
E krozhave bosh ndër t'varfnit e t'untit.

Epoka e të paktave, krozhave prej arit,
Më pak të sermtave, e plot prej xukthit,
Krozhave boshe të shpirt ëndrrimtarit,
Krozhave të randa, që shtypin pabuksit.

Edhe bota vetë, një krozhë që po kalbet,
Që mrena zien, vlon, digjet e shtypet,
Pastaj me lang loti e gjaku gjithandej laget,
E muri po i çartet, dalngadalë po myket.

Veç shpirtnat, shpirtnat s'kanë krozha,
Ata, kohë pa kohë fluturojnë drejt qiellit,
T'libër, t'burgosur, t'mbërthyem n'gozhda,
Disa drejt parajsës, të tjerë drejt ferrit.

Profetët e shpresës, mallkojnë krozhat,
Mbushun me kryma që ushqejnë korbat!

TROPOJANES

Kur e shoh unë tropojanen,
Rreze bjeshke, shtatselvie,
Zemra rreh, imiton gjamën,
Shpirti futet n'valë stuhie.

Kur i shndrisin t'bukrit sy,
Porsi uji, në Valbonë,
Gjanë e gjatë shpirti aty,
Asht' i etshëm përgjithmonë.

Kur m'shikon a kur buzqeshë,
Porsi flladi i lehtë, puhizë,
Shpirti em seç çohet peshë,
E krejt mishi ba kokrrizë.

E kur vargut s'ia gjej anën,
Metafora m'ven në lojë,
Shpirti em me tropojanen,
Zot si s'linda në Tropojë!?

DI ME JU DASHTË

Ma keni vra shpirtin nga pak e përditë,
M'keni sha, fye, veç sa s'më keni vdekun,
Po unë s'jam mposhtë, as jam mërzitë,
N'kambë kam qëndrue përhërë i paepun.

Dhe sot e kësaj dite prapë s'ndryshoni,
Hidhni baltë e zeher sa mundni mbi mue,
E pavarësisht që ju kurrë s'më doni,
Ani' për ç'ka bani, unë prapë ju due.

Ju due me shpirt dhe pse s'meritoni,
As unë s'meritoj t'më silleni ashtu,
Ju lindni e vdisni e s'dini të doni,
Por unë s'mund të bahem sikur jeni ju.

Pra jeni të padashtun, të ashpër, të vrazhdë,
Ju s'dini të doni, por unë di me ju dashtë.

(17 prill 2017)

S'KAM DITË ME DASHTË

Kam mendue gjithmonë veç për dashninë,
Për t'mposht' me shpirt jetën e vrazhdë,
Ndonëse për të, dhashë gjithë energjinë,
Prapë fundi doli se s'kam ditë me dashtë.

Me pas ditë me dashtë, do isha i ngopun,
E shpirti jem do t'ish i gëzuem si parajsë,
Por asht' i varruem me sy të përlotun,
Ndaj i thom vedit, s'ke ditë me dashtë.

Megjithëse dashninë e skalita në shpirt,
Me pakicë mora e me shumicë dhashë,
Mblodha rreth vedit ma shumë terr, se dritë,
E duel bilanci se s'kam ditë me dashtë.

Por gjithsesi, unë s'di për me u pendue,
Se s'kam çka i baj të shkretës rrashtë,
Sa ta kem jetën, do t'vazhdoj të due,
Ani pse s'kam ditë e nuk di me dashtë.

Edhe në u kthefsha në fosile të lashtë,
Prapë do due, le mos t'di me dashtë.

E PI KUPËN

E pi kupën që të dehem,
Të harroj çfarë kam kaluar,
Por kujtimet dot nuk treten,
Veç më shtohen kalëruar.

E pi kupën krejt me fund,
Mallkoj kohën me gjithë shpirt,
Që më dha vuajtje e mund,
Vetëm terr e, krejt pak dritë.

E pi kupën ëndërruar,
Mbushur plot, përplot zeher,
Si jetimi shpirt bekuar,
Që kalon jetën në ferr.

E pi kupën, kupë i thënçin,
Me oreks prej pijetari,
Mbush e zbraz, mendtë më lënçin,
Me mbarim, sërish së pari.

E pi kupën. kurrë mos pifsha,
E mos qofsha, kurrë më mirë,
Kur jeton një jetë me bisha,
Më mirë dehje me dëshirë.

E pi kupën plot me helm,
Me kënaqësi, të gënjehem,
Në mos vdeksha si një qen,
Më mjafton veçse të dehem.

E pi kupën që vet t'tallem,
Kupë të madhe, kupë mbretit,
Të mbaj iso, të hedh valle,
Në logun e mjer' miletit.

Në një jetë që t'kall krupën,
Dua s'dua.... e pi kupën!

RULETË

A ju pëlqen të ju dojë fati,
Të qeshni e gëzoni në jetë?
Harrojeni, i shkurtër afati,
Se jeta, është ruletë.

A doni të jeni perfeksion,
Njerëz të ndershëm, të drejtë?
Harrojeni, koha s'mjafton,
Se jeta, është ruletë.

A doni ta shijoni djersën,
Të lumtur, të dashur, të qetë?
Shijoni me epsh vdekjen,
Se jeta, është ruletë.

A doni të vdisni e të ringjalleni,
Të jeni t'pavdekshëm, të shenjtë?
Mjafton me jetën të talleni,
Se jeta, është ruletë.

Po mposhtët kohën, afatin,
djersën, vdekjen dhe jetën,
Vetëm atëherë do keni fatin,
Të bëni për vete ruletën.

AMANETI I ESHTNAVE

Kena lind në botë të ashpër, të vrazhdë,
Të shejtuem prej gjithçkaje e asgjasë,
Kena lind me u dashtë e s'jena dashtë,
Jena ba zengjin n'kurriz t'fukarasë.

Kena thanë bota, jena vetëm na,
Pa ju gzua djersës, pa ju gzua mundit,
Kena thanë, kena lindë me pas gjithçka,
Veç duke kenë, besnikë të unit.

E tash kur bajmë rezumenë e jetës,
Druhna e thona kjo jetë asht' asgja,
Shkojmë der atje në mohim të vetvetes,
Veç mallkojmë fatin pa pra', pa pra'.

E sot e kësaj dite e mashtrojmë vedin,
T'u e mbush mburoja për me prit' heshtat,
E kurrë se plotësojmë, të shenjtë amanetin,
Të vetmin amanet që na lanë eshtnat.

“Në doni dritën e pambarue,
Mbajuni në eshtnat, unik të bashkue”.

ZHELET

A mund ta kuptoni dot, fjalën zhele,
Atë që i thërrasim ndryshe dhe rreckë,
Ajo rroba e grisun e bame fërtele,
Që e mban fukaraja, derisa të vdesë.

Ajo rrobë, sot na asht' ba modë,
Sa krejt njerëzia lakmon në zhele,
Si zhelet tona, s'ka kund në botë,
Aq sa dhe ujku na ngjan me dele.

Kena zhele të pastra, zhele të ndyta,
Zhele të ndritshme, zhele prej ari,
Zhele ku së parës i merr shpirtin e dyta,
Bollek me zhele si nditë pazari.

Bollek me zhele, jashtë çdo etike,
Sukses pazari, sukses n'ankand,
Sukses me zhelet politike,
Sukses prej zhelesh me injorantë.

Dhe mendja krejt na asht' ba zhele,
Zhele të mbushun gjithandej plot,
E unë lutem prej shpirti e zemre,
“Na largo prej zheleve, të lutem o Zot!”

REVOLTË

O Zoti Im,
me Ty sot,
jam i paknaqun kryekput,
Nuk di pse kam,
nji
revoltë shpirtnore,
sot me ty,
Jam ba me t'ra hashe,
me u ba çifut,
Me t'sha,
me t'fye,
me t'ra,
...Veç me shfry!
E di,
Me revoltën teme,
veç vetveten rrej,
Se ti s'më del përpara,
E unë s'kam se ku t'gjej.

KAM DASHT ME T'THANË

Kam dasht me t'thanë shumë gjana t'shpirtit,
Shumë të mshehta, kam dasht me t'i thanë,
Por s'kam mujt me dalë jashtë apokalipsit,
Me dalë jashtë vedit, s'kam mujt me dalë.

Kam dasht me t'shp reh, ç'ka s'ta merr mendja,
Ato që kurr s'ke mujt me i mendua,
Me thanë o zot, ç'ka po m'pson zemra,
Po vetvetja jeme me vrik m'ka ndalua.

Kam dasht me kenë ai që nuk jam,
Me u shkri mes akullit, krejt m'u ba lang,
Po pa fund kam urrye fjalën haram,
E jam mjaftua me i ba vedit dam.

Oh, sa kam dasht me kenë një me ty!
Me thirrë me bzamë për një lindje bote,
Por s'kam dasht me t'lëndu për asnjë arsy,
Me ma djeg shpirtin mosprezenca jote.

Kam dasht me t'thanë, zot, ç'kam dasht me t'thanë,
Por prap mirë që s'të thashë, se as sot s'do t'kisha thanë.

TI S'KE PROVU

Ti s'ke provu puthjen me t'u langzu eshtnat,
S'ke shiju me andje qiellin e shtatë,
S'ke provu trupin me ta përshku heshtat,
Me thanë çfarë k'naqsie asht' me u dasht.

Ti s'ke provu me t'u ba mishi kokërr,
Prej afshit t'andruem të yjeve të djegun,
Me u ba hana diell e toka ba gogël,
Me shiju parajsë edhe pa vdekun.

Ti s'ke provu me dit' çka asht' jeta,
Se jetën pa jetë, në heshtje jetove,
Të mashtroi rrena e t'mohoi e vërteta,
A linde a vdiqe kurrë s'e kuptove.

Ti s'kuptove, s'kupton as ke për të kuptuar,
A linde të vdesësh, a vdiqe pa jetuar?!

AROMË PRANVERE

Vërshojnë lëngjet në lastarët e njomë,
Fryhen sythet në përgatitje për t'çelur,
Diellin e ngrohtë shoqëron puhizë e hollë,
Blegërojnë të imtat, livadheve duke bredhur.

Fëmijët lozin me gëzim në lëndina,
Zogjtë cicërojnë ndërvete shpupurohen,
Vashat krehin flokët brune, bjondina,
Djemtë pas tyre flirtojnë e ngacmohen.

Pleqtë ngucin dimrin, të lamë dhe kët' herë,
dalin shëtitje me gratë në përkujdesje,
Ikja e dimrit lajmëron për pranverë,
Natyra e qetë fal dritë e buzëqeshje.

Mbetet unike, shprehja përherë,
“Pas çdo dimri... ka pranverë”

PO VYSHKET LULJA

Po vyshket lulja përditë o mjeran,
Dalëngadalë po i humbet aroma,
Po thahet e dheu më nuk e mban,
Çka na i hijeshon më zemrat tona?!

Po vyshket e sporet po ja merr era,
Larg po i çon, larg në mërgim,
Po mbetet vendi veç shkurre, ferra,
Tek-tuk ndonjë bimë e pa prodhim.

Po vyshket lulja, krejt po vyshket,
Po thahet e shkreta luleborë,
Porsi hekuri që veçse ndryshket,
E mbushet vendi veç me skorje.

Po mendo njëherë, o njeriu i zotit,
Ujite lulen... e nxirre në dritë,
Mos e vadit me kokrrën e lotit,
Nga loti merr veç helm, veç kripë...

LULEFERRË

E pranishme, e dukshme, e kudondodhur,
Shfaqesh si lulja e bukur, plot me erë,
Luan me ndjenja, në ca shpirtra të lodhur,
Thumbon, ti kaktus, ti luleferrë.

Kënaqesh, triumfon mbi shpirtdëmtuarin,
Vetja të duket se ke shumë vlerë,
Që me këmbë e shkel të dashuruarin,
Ti si një lule, je veçse ferrë!

DHURATA

Këtu e kam dhuratën që zgjodha,
E ruaj të shenjtë engjëjlore,
Më preke, më vrave në shpirt me lodhe,
Se kurrë ti s'erdhe, kurrë s'e more.

Këtu do të rrijë gjithmonë e paketuar,
Le të kalojnë vitet, të kalojë jeta,
Sa herë ta shoh, kam për të kujtuar,
E prap do jem, aty ku mbeta.

Nëse dikur do shembet bota,
E mua me vrull do më tërheqë nata,
Nëse gjithë drita do jetë e jotja,
Bashkë me ty do të jetë dhurata.

Atëhere, këtë dhuratë të padhuruar,
Pranoje të lutem, për të më kujtuar.

A KËRKOJ SHUMË?!

Asnjëherë s'kërkova çka s'më përket,
S'desha pallate, para, pasuri,
Kur bëhem lypsar për pak njerëzillëk,
Një fjalë të ngrohtë, pak çiltërsi.

S'dëshirova njohje si emër me famë,
As dorën shtriva kërkues ndaj zotit,
Veç pak ngrohtësi nga toka amë,
Që të zbus dhimbjen, të përthaj lotin.

S'kërkova grada tituj as poste,
Përveçse një titull të vetëm njeri,
Shoqëruar me respekt e mirënjohje,
Në detin e quajtur dashuri.

E bëj unë pyetjen, drejtuar në turmë,
Më thoni ju lutem, a kërkoi shumë?!

GJITHÇKA

Krejt botën në dorë e pata,
Në ëndërrimet e mia pafund,
Por më dukej e errët si nata,
Se ty s'arrija të t'shijja askund.

E kisha timen gjithësinë,
Ne mendimet e mia si një hartë,
Por ajo më dukej vogëlsirë,
Pa praninë tënde të zjarrtë.

Të madhe e pata dashurinë,
Për qiellin, për tokën, për detin,
Por ajo s'ë kish ëmbëlsinë,
Pa ty, s'ë kishte lezetin.

E pata, e çfarë nuk pata,
Në ëndërrime porsi një pasha,
Në të vërtetë, asgjë nuk pata,
Me ty tani, kam gjithçka.

ASGJË...

(Historisë)

Asgjë ti s'dhe e asgjë s'more,
Dekompozim i plotë, fije-fije,
S'llogarite humbje, s'korre fitore,
Kurrë s'pe dritë, por vetëm hije.

Asgjë nuk shprehe, asgjë s'the,
Veç lotë mërzie, përcolle grumbull,
Të zhgarraviti, çdokush me nge,
Ty, histori e shekullit të humbur.

Kurrë e vërtetë, me fjalë e zë,
Për një traditë, për një kulturë,
Morëm nga ti gjithmonë, asgjë,
Ti e vërtetë, nën dhe, mbi gurë.

Një brez të merr, tjetri të lë,
E përherë nga ti, marrim asgjë...

BRENDA TE JE

Kur të t' marrë malli për mua,
Po qe natë, e kthjelltë me yje,
Fjalë të shumta s'ke pse thua,
Veç ta dish, jam midis tyre.

Kur për mua malli të t' marrë,
Ditë me diell, anë e mbanë,
S'ke pse shprehesh më me fjalë,
Me një rreze, të vij pranë.

Kur të t' marrë malli për mua,
Zjarrdëshira, gjak ndër deje,
Asnjë fjalë s'ke pse e thua,
Se unë gjendem brenda teje.

PERËNDIM DIELLI NË BREGDET

Perëndimi i diellit sa i ëmbël në bregdet,
Rrezet ndriçuese mbi valët onde-onde,
Më bëjnë të ndihem si princ a si mbret,
Pasi në perëndim t'kisha dhe ty në sfond

Kur dielli me detin u fal e perëndoi,
Ranë hije të stërgjatura anembanë,
S'mendova për diellin nga vajti, ku shkoi,
Se t'kisha për diell ty aty pranë.

...

Na gërryet, na ropët,
Të ndarë dhe bashkë,
S'latë kokërr as kashtë,
Kurrë s'u ngopët.

U frytë, u trashët,
Me eps, ju çifutët,
Shtuat të pabukët,
E prapë, s'u kënaqët.

E vazhdoni, lugatët,
S'i ndaheni dëshirës,
Motivues të rrësirës,
T'ju rrojnë aleatët!

Na përçmoni, na shtypni,
Përdhosni kulturë,
Ne kockë e lëkurë,
Prapë, lypni e lypni.

Na mbani të përçarë,
Me zjarr e dëshirë,
Kot s'jeni vampirë,
Me soj, e me farë.

AH DASHNIA EME!

Ah dashnia eme ,
e çorjentueme,
e përçartun,
E shpërndame ,
e vrame,
pa pra' e përdalun,

Ah dashnia eme,
e ngutshme ,
e etshme ,
e pa matun,
Gjithmonë e ambel,
e mëkatshme,
e pafalun.

Ah dashnia eme ,
e pa kufi,
krejt e pa limit,
E flakun,
tretun,
e pjekun,
e papjekun,

Ah dashnia eme ,
e kryqzueme,
e kthyeme në hibrid,
E mbjellun,
rritun e korrin ,
në tokën e djegun..

Ah dashnia eme,
e mshtjellun,
në një shpirt a zemër,
E shkrujtun,
me qindra e mijra maja lapsi a pene,

Ah dashnia eme ,
simbol i ma t'bukures femër,
Për ty do shkrihem tan jetën,
Dashnia eme!

ALIBI!!!

S'di ç'dreqin deshën, perëndeshat e mia,
Pse me pathos hynë tek unë, s'kam idenë?!
Se për to s'isha tjetër, veç si ajo hija,
Që stërgjatet në muzg e ik e merr dhenë.

S'di ç'panë tek unë, s'di ç'u pëlqeu,
Aq sa shpirtin me dëshirë, bëjnë lëmsh,
S'di ç'ish ajo gjë që aq fort i gënjeu,
Të rendnin pas meje, si të lojtura mendsh.

Vijnë perëndeshat, vijnë e shkojnë,
Përditë e më tepër ma shtojnë habinë,
Ndonëse vetveten aq fort torturojnë,
Me asnjë kusht s'ma pranojnë alibinë!

PËR ULEM

(Dedikim të diskriminuarve për idealet e lirisë)

Ju, ishit ata që vuajtët shpirtërisht,
Për botën e lirë qëndisur në pëlhurë,
U vetëflijuat, masakruat, vullnetarisht,
Me vuajtje shpirti, në trup, në lëkurë.

Kufizuat vetveten me dashje, vetwdije,
Me dëshirë për një botë të drejtë, të lirë,
Përballuat torturat siç heronjëve u ka hije,
Ani, thatë vuajtjet, për t'ardhme më t'mirë.

Hallall bëni sakrificat për ditët që erdhën,
dhe pse paguat me pranga, me gjak,
Ju mbeteni fisnikë që koha s'ju zbehën,
E kurrë për vuajtjet s'kërkuat hak.

Jua them o miq me zemër në dorë,
Unë që s'vuajta sikur ju, ashtu,
Me të vërtetë ju jeni shenjtorë,
S'besoj t'kisha shpirtin që keni ju.

Andaj ndihem shumë i vogël para Jush,
Ju që për ideale shpirtin bëtë theror,
Jua shpreh me bindje ta mësojë gjithkush,
Përulem para Shpirtit Tuaj Madhështor!

NA, S'DONA DRITË

A keni pa,
Në festa, gëzime,
Na veç qeshim,
Asnji nuk kja.

A keni pa,
Duar të shtrime,
Na ,ndrojmë rrugë,
Ftyrvrejtun,përçmime,
Prapë s'kena kja.

A keni pa,
Morte,smundje,idhnime,
Dhimbjet mbulu me forcë,
Lotët të ngrime,
Po s'kena kja.

A keni pa,
Drejt ku po shkojmë?!
Përditë vrasim vlerat,
Shpresat, vdesin,
Na s'kena kja,
Veç qeshim,qeshim.

A keni pa,
A shihni përditë,
Se jena t'fortë ,me shpirt t'ngurosun,
Na s'dimë me kja,
As n'kyt jetë as n'jeten e pasosun.

Pra,na i gzohna territ,
Na s'dona dritë,
As n'parajsë,as n'gropë t'ferrit,
Se jena sende,nuk kena shpirt!

UDHËKRYQET E JETËS.

Në udhëkryqet e jetës përplasur,
Pa ditur rendim kuturu,
Takohemi rastësisht, si pa dashur,
Në udhë për të shkuar diku.

Ndalemi e themi, o sa mirë,
Të duhemi, a një hall të qajmë,
Por gjuhë e përbashket vështirë,
Prap rrugët e jetës na ndajnë.

S'na mbetet veç një imazh,
I çastit, i fshehtë, i padukur,
Një valë deti, e vogël valëz,
A fragment, i një filmi të bukur.

Një puthje lë shijen e hidhur,
Të ikjes, të humbjes, të tretjes,
Dhe një shpresë për tu rilidhur,
Prap në udhëkryqet e jetës.

Prapë, në kërkim të vetvetes,
Diku në udhëkryqet e jetës!

FLAS ME YJET

(Nënës)

Në mungesë të pranisë tënde,
Malldëshira është bërë nyje,
Vështroj yjet, ti në mendje,
Veç për ty, rri flas me yje.

Marr e pyes, në të kanë parë,
Vallë ku gjendesh me shejtnitë,
Sytë m'janë shterrur, pa të parë,
Më mungon, aq thellë në shpirt.

Në të pafshin, dot gjëkund,
Të dërgoj shumë përqafime,
Nga degë yjesh që do shkundi,
Të t' vijnë pranë me rrezatime.

E mbi ty, të t'shndrijnë kurorë,
Me zjarr shpirti, përmbi krye,
Dhe një zemër shtrirë në dorë,
E formuar, veç me yje.

Mbasandej, rri pres sinjal,
Nga gjithë yjet mbi ty rënës,
Një shkëndi që veç ti fal,
Me buzëqeshjen e hënës.

E me dritë shijoj natyrën,
Diellin, tokën, fushat, pyjet,
Buzëqeshja me fytyrën,
Sinonim vetëm me yjet.

KUJT I BAMË DAM!?

E kena hangër jetën jo me lugë, me luginë,
Jena dasht sa se përshkruan asnjë maje pene,
Je ngri si akujt në acar a në ngricë,
Për pasojat s'kena mendu, se s'kena pas mendje.

Na kanë tremb fjalët e kalimtarëve,
Jena gri mes vedi a mundna, a duhet?
U jena msheh paparacëve e deshmitarëve,
Po dashnia s'ka mujt me u m'shi, as të shuhet.

Sot prapë jena t'lumtun për dashninë e rrallë,
Pse ish kundër rrjedhës që serviri jeta,
Prapë mendojmë e veprojmë të dy si të marrë,
E druhna prej hijesh mos del e verteta.

Po n'fund të fundit kujt i bamë dam,
Kë vallë trazuam me dashninë tonë,
Kush dashni s'merr a dashni s'fal,
Vallë a mundet n'ktë jetë të gëzojë?!

...

Mendojmë se jemi pafund të përjetshëm,
Në një jetë që zgjat, sa hap e mbyll sytë,
Bëhemi të egër, të dhunshëm, të et'shëm,
E s'gëzojmë as të parën, as jetën e dytë.

JANË ATO...!

Me ngërç në fyt a vrull dëshire,
Me yje qielli a me valë deti,
Me afsh shpirtëror, të botës hire,
Jeton ikona me ëndrra mbreti.

S'ka rëndësi nëse s'ke fron,
Krejt pa rëndësi nëse s'ke petk,
Mjafton të ndjesh çfarë dëshiron,
Në botën tënde të ndihesh mbret.

Nuk është e thënë t'kesh gjithçka,
As diamante mbushur me thasë,
Mjafton në shpirt të kesh diçka,
Që botën tënde, kthen në parajsë.

Se janë ca gjëra që kurrë nuk shihen,
Nuk kanë çmim, se dot s'peshohen,
As nuk shiten dhe askund s'blihen,
Por me asgjë, nuk zëvendësohen.

Janë veç ato, që në jetë të jetëve
U bëjnë kolaps jetën profetëve.

PËR NJË NATË TË MIRË!

Nëse plagët e dashurisë s'do ishin t'shërueshme,
Dhe fati i jetës tonë do ish një numër fiks,
S'do kishim nevojë për rrezeplotat ndriçuese,
Do mjaftoheshim me jetën, gjithmonë nën eklips!

PËR TO...

I duam çmendurisht,
I tradhtojmë me etje,
I himnizojmë botërisht,
Me to gjer në vdekje!

Vdesim para tyre,
Ne, hijet pa atdhe,
Si shembëllim pasqyre,
Ato vdesin me ne.

E mbetet thënia, kurorë e artë:
"Mos qofshin burrat, që s'rrojnë për gratë"

ASKUSHI

Një hyjnor mendjen ma mbushi,
Se unë në jetë qenkam askushi,
Sa për qejf, sa për inat,
Në mes të pyllit shkova një natë,
Si burrë i vjetër a si një plak,
Mora e ndeza një zjarr bubulak.
Kur trupi u ngroh e dora mu rreshk,
Shkova në lumë, zura ca peshk,
E me ngadalë u ktheva në vatër,
Të pjek ca peshk, për qejf, për hatër.
Por siç po rrija ashtu, pa parë,
Afrohet një burrë, thotë punë e mbarë!
E pa më marrë aspak leje,
Vjen e ulet krejt afer meje.
Po mbante shtrënguar në dorë një kërrabë,
Në majë të saj kish' vendosur një zhabë,
Thashë ta mbërthej e ta kthej zgraphi,
Kur vura re, këmbët së prapthi!

U ngriva o miq, më zuri halli,
 Se ai na ishte, vetë djalli,
 Kisha dëgjuar, djalli shfaqet pors i njeriu,
 Por këmbët së prapthi, ka ai i ziu.
 Mbeta i shkreti, ashtu në siklet,
 Thashë ta marr shtruar me muhabet.
 E pyeta për emrin, e quanin Dudush,
 Po ty, më thotë? –Më quajnë Askush,
 Dihej që djalli shumë s'do duronte,
 Filloi ngadalë të më ngacmonte,
 Të tallet me mua, të më vërë në lojë,
 Zhabën me peshkun nis të fërkojë,
 Më, nga nervat, unë s'u durova,
 Me dru të ndezur djallin qëllova,
 Ai mori zjarr, u bë vetëtimë,
 E nga të vëllezërit kërkoi ndihmë.
 Oh, thashë me vete, më piu e zeza,
 Do më çojnë djajtë shpejt në varreza.
 Kush të qëlloi pyesnin, o vëlla Dudushi?
 Ai përgjigjej, - Më dogji Askushi,
 Me emrin Askushi djalli gaboi,
 Vëllezërit thanë, po na vë në lojë,
 Po na gënjen Dudushi anës lumit,
 Shkojmë o vëllezër, e ja futim gjumit,
 E unë ia hodha, nuk ishte lojë,
 Jetën Askushi këtë herë ma shpëtoi,
 Kjo ishte ngjarja o miq të shtrenjtë,
 Ka pak rëndësi në ish e vërtetë,
 Por nuk më thoni, mendja a iu mbush,
 Është mirë ndonjëherë, të jesh Askush?

PËRMBATJA

<i>MËKATAR</i>	1
<i>E BRISHTË...</i>	2
<i>MË GUR SE GURI...</i>	3
<i>S' MUNDEM TË HARROJ...</i>	4
<i>VETËM NË SYTË E TU</i>	5
<i>NË MUZGUN E MBRËMJES</i>	6
<i>DIKUR...</i>	7
<i>TË NJËJTIN GABIM</i>	8
<i>MENDO...!</i>	9
<i>NË ËNDËRR</i>	10
<i>KAM HARRUAR TË BUZËQESH</i>	11
<i>PRITJE</i>	12
<i>S'MUND TË MBAJ</i>	13
<i>HESHTJE</i>	14
<i>NJË ME QIELLIN</i>	15
<i>KONTRASTE JETE</i>	16
<i>IKONË</i>	17
<i>MEDITIM KONFUZ</i>	18
<i>NJË FESTË...</i>	19
<i>PËRSE MA VRAVE ENGJËLLIN?!</i>	20
<i>S'KA RËNDËSI NË PARAJSË A NË FERR</i>	21
<i>DORA</i>	22
<i>DEBAT ME PENËN</i>	23
<i>SHPËRNGULJA</i>	24
<i>NDASHTË</i>	25
<i>MË MIRË ISH DJE, A MË MIRË SOT?!</i>	26
<i>FALJA</i>	27

KUR...	28
SA MIRË TË JESH, NJERI I THJESHTË	29
PERDJA RA	30
THASHË TA PROVOJ	31
TI FEMËR	32
BOTË E ÇMENDUR	33
KALI	34
DUAJE VETVETEN	35
ATJE	36
SA SHUMË MË MUNGON	37
S' MUNDEM DOT...	38
BRIGJEVE TË VALBONËS	39
UJËVARË	40
NOTA TRISHTIMI	41
PËR TY KAM SHUMË NEVOJË	42
I HUAJ?!	43
BOTA	44
PORTRETI I POETIT	45
MË MJAFTON	46
SHUPLAKA	47
PERANDORI RA!	48
SHUMË HERË...	49
U TËRBUA BOTA	50
PASZGJEDHORE	51
KROZHAT	52
TROPOJANES	53
DI ME JU DASHTË	54
S'KAM DITË ME DASHTË	55
E PI KUPËN	56
RULETË	58
AMANETI I ESHTNAVE	59
ZHELET	60
REVOLTË	61
KAM DASHT ME T'THANË	62
TI S'KE PROVU	63
AROMË PRANVERE	64
PO VYSHKET LULJA	65
LULEFERRË	66
DHURATA	67

<i>A KËRKOJ SHUMË?!</i>	68
<i>GJITHÇKA</i>	69
<i>ASGJË...</i>	70
<i>BRENDA TEJE</i>	71
<i>PERËNDIM DIELLI NË BREGDET</i>	72
...	73
<i>AH DASHNIA EME!</i>	74
<i>ALIBI!!!</i>	76
<i>PËRULEM</i>	77
<i>NA, S'DONA DRITË</i>	78
<i>UDHËKRYQET E JETËS.</i>	80
<i>FLAS ME YJET</i>	81
<i>KUJT I BAMË DAM!?</i>	82
...	83
<i>JANË ATO...!</i>	84
<i>PËR NJË NATË TË MIRË!</i>	85
<i>PËR TO...</i>	86
<i>ASKUSHI</i>	87



Lulzim Kalaj

U lind në Lezhë me 23 prill 1970. Ka kryer studimet në akademinë “Skënderbej”, dega Artileri Bregdetare. Ka botuar librin e parë me poezi “I imi mekat” me 2011. “Ndashte...” është libri i dytë poetik.

Asht libër shumë fin, modest, i rrjedhshëm...! Përcillet si ajri...! Asht transparent si dritë...

Elinda Marku

Muza poetike e Lulzim Kalajt shpalon dallueshëm tiparet substanciale të lirikës në tërësi nëpërmjet një prozodie poetike, që i jep asaj një muzikalitet të lavdrueshëm. Në këtë vëllim autori shënon një hap të sigurt në ballafaqimin dinjitar me produktin poetik të promovuar në gjithë hapsirën shqiptare.

Viktor Gjokolaj

Poezia e Lulzim Kalajt asht shenja e qartë e ekzistencës së poezisë së ndjerë në kohët e sotme. Vargu i kësaj poezie ka frymën e një shpirti të madh, arma e duhur për një Poet që t'i gdhendet emni në gurin e letrave shqipe!

Nikoleta Kovaçi

